



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

5814/2  
Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 25/11/2022

URDHËR

Nr. 630, Datë 25/11/2022

**“PËR CAKTIMIN E DITËS, ORËS, VENDIT TË ZHVILLIMIT TË PROVIMIT TË KUALIFIKIMIT PËR NOTERË, AFATIT TË PARAQITJES SË KËRKESAVE PËR SHPREHJE INTERESI PËR TË HYRË NË PROVIM DHE DOKUMENTEVE PËRKATËSE QË DUHET TË SHOQËROJNË KËRKESËN”**

Në mbështetje të nenit 6 dhe 7, të Ligjit nr.8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të pikës 1 dhe 2 të nenit 9 të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar, të pikës 4 të Urdhrit nr. 347, datë 15.10.2020 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e Rregullores së Provimit të Kualifikimit”,

**URDHËROJ:**

1. Caktimin e datës 10.12.2022, ora 10:00, për zhvillimin e provimit të kualifikimit për noterë, në Sallën e Konferencave të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Paraqitjen e kërkesave për shprehjen e interesit për të hyrë në provimin e kualifikimit për noter, jo më vonë se 15 ditë përpara ditës së organizimit të provimit, të caktuar në pikën 1 të këtij urdhri.
3. Çdo kërkesë për shprehjen e interesit si më sipër, duhet të shoqërohet nga dokumentacioni si vijon:
  - a. Kopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë apo letërnjoftim ID);
  - b. Jetëshkrim;
  - c. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti);
  - d. Diplomë e noterizuar për të dyja ciklet e studimit bachelor dhe master shkencor ose diplomë për drejtësi jashtë shtetit, të njësuar në përputhje me rregullat për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;
  - e. Vërtetim për moshkarkimin nga ushtrimi i detyrës ose funksioni publik, për arsye të integritetit etik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë, me përjashtim të rasteve kur masa disiplinore është shuar sipas legjislacionit të posaçëm;

- f. Kopje të certifikatës së përfundimit me sukses të formimit fillestar të detyrueshëm pranë Qendrës Shqiptare të Trajnimit të Noterëve;
  - g. Vërtetim për ushtrimin e veprimtarisë si asistent noter me kohë të plotë, për dy vjet, pranë një noteri.
4. Ngarkimin e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, për marrjen e masave për zbatimin e këtij urdhri.
5. Publikimin e këtij Urdhri në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Ulsi Manja**

